

VENDIM
Nr. 486, datë 25.7.2012

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT, 2012-2015 DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË INSTITUCIONALE PËR PËRAFRIMIN NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR TË ÇDO AKTI TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), 2012-2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integritit orienton, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2012-2015 (më poshtë PKZMSA, 2012-2015), si dhe procesin e shpërndarjes së *acquis communautaire* për çdo kapitull nga: ministrinë, grupet ndërinstitucionale të punës (GNP), të ngritura me urdhrin nr. 183, datë 11.12.2009 të Kryeministrit “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis communautaire*, duke përfshirë edhe kapitujt e kriteret politik dhe ekonomik” dhe institucionet e tjera qendrore. Ministria e Integritit raporton çdo 3 (tre) muaj në Këshillin e Ministrave për ecurinë e procesit.

3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Integritit, çdo 3 muaj (java e tretë e muajit të fundit), për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga PKZMSA, 2012-2015 dhe për ecurinë e procesit të përafrimit të *acquis communautaire*.

4. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit, të monitorojë përfshirjen në programin buxhetor afatmesëm të nevojave financiare për zbatimin e përparësive, afatshkurtra dhe afatmesme, të parashikuara në PKZMSA 2012-2015, nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore.

5. Brenda 4 (katër) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, të cilat janë pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës, të përcaktuara në urdhrin nr. 183, datë 11.12.2009 të Kryeministrit, nën koordinimin dhe monitorimin e Ministrisë së Integritit, të përcaktojnë përgjegjësitë institucionale për përafrimin e çdo akti të legjislacionit të BE-së në legjislacionin e brendshëm.

6. Rregullat më të hollësishme për mënyrën e përcaktimit të përgjegjësive institucionale, për përafrimin e çdo akti të legjislacionit të BE-së në legjislacionin e brendshëm, me propozimin e Ministrit të Integritit, të miratohen nga KNIE-ja, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Vendimi nr. 463, datë 5.7.2006 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, për të cilat në PKZMSA, 2012-2015 janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha